



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 16 prot.

Kamëz, më 3. 2. 2022

V E N D I M

Nr. 14 Datë 3 / 2 2022

MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE TË CILËT PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT PËR OBJEKTET KOLEKTIVE, (PALLATET E VALIASIT) TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 03.02.2022 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim Projekt –Vendim Nr.14 Datë 03.02.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Aktin Normativ nr. 09 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar; Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”; Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”; Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”; Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”; Vendimit nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për objektet kolektive, (Pallatet e Valiasit) të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt-ekspertizat e thelluara nga Instituti i Ndërtimit me nivel dëmtimesh “Për Shembje”. (Faza III)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehim, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Ndihmës Eknomike dhe Çështjeve Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

